

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" COMFORT AIR " SHPK

Në Tiranë, Sot, me datën 05.08.2019 (dy mijë e NENTEBëdhjetë), në Tiranë, në themeluesit kemi krijuar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "**COMFORT AIR**" SHPK, me Seli Tiranë, Njesia Administrative Farke, Lagjia 13, Rruga "Shyqyri Brari", Pallati Nr 8, Apartamenti 8. Themeluesit e shoqërisë janë, **Fabio Eqerem Nezhaj** i cili me cilësinë e "përfaqësuesit të Ortakut themelues" të shoqërisë "**COMFORT AIR**" SHPK hartoi aktin themelimit, i cili me deklaroi se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008. "Për shoqëritë tregtare", në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoi shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar "**COMFORT AIR**" SHPK.

KREUI I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**COMFORT AIR**" SHPK, është person juridik i së drejtës shqiptare. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, më poshtë e quajtur "Shoqëria".

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**COMFORT AIR**" SHPK, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetëm, që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka Seli Tiranë, Njesia Administrative Farke, Lagjia 13, Rruga "Shyqyri Brari", Pallati Nr 8, Apartamenti 8.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Administratorit.

Neni 4

Kohëzgjatja


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Tregti, Import – eksport, me shumicë e pakicë të pajisjeve elektronike, elektro-shtëpiake, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, Impiante të brëndshme elektrike, programime në fushën e IT dhe mirmbajtje rrjeti, telefonike, radiotelefoni TV, si dhe servis të tyre, servis kompjuterësh dhe pajisje telekom, pajisje hidrosanitare, bar – bufe- restorant – hoteleri, mallra industriale, konfeksione, materiale ndërtimi. Tregti me shumicë dhe pakicë i pajisjeve dhe sistemeve për mbrojtjen nga zjarri



dhe sistemeve të tjera sigurimi dhe detektimi. Tregtim i sistemeve kompjuterike per Perpunim Informacioni dhe Transmetim.Prodhim i programeve aplikative. Instalimi i sistemeve te Informacionit dhe te Nderlidhjes.Sherbim i sistemeve elektronike ne cdo fushe te ekonomise.Tregtimi i pajisjeve dhe sistemeve elektronike ne cdo fushe te ekonomise.Aktivitete te tjera, qe vecmas ose sebashku me ato te mesipermet, do te konsiderohen te papershtatshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesemarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Punime gërmimi në tokë, gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, Ndërtime civile e industriale si dhe shit-blerja e tyre. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Punime nëntokësore, përfshire galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele. Diga dhe tunele hidroteknike. Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjise elektrike. Ndërtime, mirëmbajtje, ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose që janë të nevojshëm për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshire edhe të gjithë impiantet mekanik, elektromekanik, elektrik, telefonik, elektronik, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë. Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet. Ndërtime për nënstacione, gabinet e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Punime të inxhinjerisë mjedisore. Punime për prishjen e ndërtimeve, Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Montimi dhe mirëmbajtje, ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatik, të kompletuar me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. Projektim dhe zbatim i sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve të tjera sigurimi dhe detektimi. Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, Montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to e kompletuar me çdo punime të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjerë që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre. Montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë të gazit dhe kundra zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues). Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore special. Shtresa dhe mbistruktura speciale. Punime në shina dhe traversa. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Pastrimi i ujrave detar, liqenore dhe lumorë. Ndërtimi i impianteve të ujit të pishëm dhe pastrimit të tij. Punime topogjeodezike. Sistemi i mbojtjes nga zhurmat në infrastructure. Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Shoqeria munde te bashkepujtoje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj. Shoqeria ka të drejtë të shtojë objektin e veprimtarisë së saj, në çdo kohë sipas ligjeve në fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 Kuota të barabarta, vlera nominale e të cilave është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga:

Ortaku themelues **Fabio Eqerem Nezhaj**: Zotërues i 1 kuotave me vlere te përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, qe përbën 100 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.



Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime. Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve, nëpërmjet akteve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj

pike;

- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

4. Ortaku i vetëm mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.

5. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit



Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetëm.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

Ortaku i vetëm vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administratori i shoqërisë është Z. **Fabio Eqerem Nezhaj**.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e tij në këtë detyre për një periudhe **pesë vjeçare**, sipas ligjit.


Neni 11

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori ka të drejtë të kryej të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.
- Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
- Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruaj kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë. përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruaje aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak,
- të nënshkruaj e hartoj çdo dokument e të kryej në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimi i kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryej veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që



akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

- Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.
- Administratorit ose ortakut që nuk është person juridik, nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Përrjashtimisht viti i parë- financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj;
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare "
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne këtë rast Ortaku i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES

- 1) **Fabio Eqerem Nezhaj**

Fabio Nezhaj
